



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.169/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3.500 (tremijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, më datë 10.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati i AAK-së për Komunën e Vushtrrisë Lutfi Bilalli ka mbajtur takim me qytetarë në fshatin Stanoc të Ulët, ndërsa në takim ka pasur edhe fëmijë dhe se takimi është mbajtur në vend publik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 35.1 të LZP-së dhe nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik AAK, deklaroi se takimi me qytetarët nga kandidati i AAK-së për Kryetar të Vushtrrisë në fshatin Stanoc të ulët ka qenë legal i lajmëruar në KKZ, dhe është në pajtueshmëri të plotë me ligjin. Subjekti politik AAK në vazhdim të përgjigjes theksojnë se pas pranimi të ankesës kanë kontaktuar me strukturat menaxhuese të fushatës, konkretisht Shtabin Zgjedhor për komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me përfshirjen e fëmijëve në fushatë theksojnë se kandidati për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti i tyre politik z. Mursel Igrishta, në pamundësi për kujdestari shtëpiake i ka marrë bashkëshorten dhe fëmijët e tij për shkak të moshës që kanë nën 4 vjeçare edhe pse lokali ku është mbajtur tubimi është në pronësi të po të njëjtit kandidat. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre, i kanë bashkëngjitur fotografinë kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik AAK, z. Mursel Igrishta dhe familjes ë tij si dhe Formularin për mbajtjen e tubimeve politike.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se në tubimin e subjektit politik AAK, në fushatë zgjedhore, janë përdorur fëmijë, në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar me arsyetimin se fëmijët e përfshirë në fushatë janë fëmijët e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal të subjektit të tyre, mirëpo pretendimet e tilla nga ana e panelit janë të paqëndrueshme dhe veprimi i tillë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ku vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. A.nr. 169/2017 më datën 12.10.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.